



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë), nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas një denoncimi të dorëzuar nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK), në vazhdimin e seancës së tij të 84-të të mbajtur më 31.03.2023, vendosi si më poshtë:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-516/1 të vitit 2022, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent si pas pohimeve të denoncuara.

Lënda me numër 12- 516 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numrin 12-516/1 e datës 31.01.2022 është formuar në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ///. Në denoncim thuhet se ///, në datën 13.01.2022, në /// kanë kryer aktivitete partiake promovimin e Qendrës Turistike ///, gjatë kohës së rregullt të punës. Nga KSHPK-ja kërkohet të shqyrtojë çështjen në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Përcjellje e ankesës janë paraqitur fotografi nga rrjeti social www.facebook.com, në formën e skedarëve.

Duke parë përmbajtjen e denoncimit dhe provat e ofruara, KSHPK-ja ka vendosur se në rastin konkret nuk ka elementë për trajtim të duhur. Kjo për shkak se nga dëshmitë e ofruara ngjarja ndodhi më 13.01.2022, në ditën kur Komuna e /// tradicionalisht mban Manifestimin e Karnavalit të ///.

Në përputhje me të theksuarën më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :
- Parashtruesi i dneoncimit

Përpiloi: Mr. D.D

**КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
НЁНКРЬЕТАР,
Katica Nikolovska**

